

C.R.I Albania Shpk

Pasqyrat financiare vjetore për periudhën nga

1 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor 2014
(dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar)



Tabela Permbledhese

C.R.I ALBANIA sh.p.k	1
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR PËR PASQYRAT FINANCIARE	3
Bilanci kontabël – Aktiv	5
Ekonomiste Administratori	5
Bilanci kontabel - Pasiv	6
Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve.....	7
Pasqyra e fluksit të parave	8
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	9
Shënime	10
1. Informacion i përgjithshëm për Shoqërinë	10
2 Baza e përgatitjes.....	10
3 Përmbledhje e politikave kontabël.....	10
4. Mjetet monetare.....	14
5. Klientë	14
6. Aktive afatgjata materiale.....	14
7. Aktive afatgjata jomateriale.....	14
8. Të pagueshme ndaj furnitorëve	14
9. Detyrime tatimore afatshkurtra.....	15
10. Fitimi (humbja) neto e vitit financiar.....	15
1 Të ardhurat.....	16
2 Shpenzimet	16
3 Shpenzimet e shpërndarjes	16
4 Shpenzimet administrative	16
5 Fitim/humbje nga kurset e këmbimit.....	17

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR PËR PASQYRAT FINANCIARE

**Drejtuar: Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë
“ C.R.I ALBANIA ” SH.P.K
Rr.e Elbasanit, Kulla “American 2”,
TIRANË – SHQIPËRI**

1. Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “C.R.I ALBANIA” SH.P.K që përfshijnë bilancin më 31 Dhjetor 2014, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël kryesore dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

2. Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit; për të zgjedhur dhe zbatuar metodat e përshtatshme kontabël dhe bërjen e cmuarjeve kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

3. Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin tonë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së opinionit për

efektetivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe llogjikën e cmuarjeve kontabël bërë nga drejtimi, si dhe për vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit tonë të auditimit.

4. Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjëndjes financiare të shoqërisë “C.R.I ALBANIA” SH.P.K më 31 Dhjetor 2014, rezultatit të saj financiar, të flukseve të parasë dhe ndryshimeve të kapitalit për ushtrimin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Këto pasqyra financiare janë hartuar në përputhje me:

- Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Standartet ndërkombëtare të raportimit financiar;
- Legjislacionin tatimor në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër, bazuar në kompetencat që më jep Ligji nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” çertifikoj pasqyrat financiare, përfshirë anekset dhe shënimet përkatëse që i bashkangjiten këtij Raporti.

Enkelejda Alite

Eksperte Kontabël e Regjistruar




Adresa: Rr.Siri Kodra, Nr.35, Tirane

Tirane, me 27 Mars 2015

Bilanci kontabël – Aktiv
Për vitin financiar deri më 31 Dhjetor 2014

	Shënime	Në Lekë 2014	2013
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	13,508,755	47,255,985
Derivative dhe aktive financiare te mbajtura per tregtim			
<i>Derivativet</i>			
<i>Aktive financiare te mbajtura per tregtim</i>			
		<u>13,508,755</u>	<u>47,255,985</u>
Aktive te tjera afatshkurter			
<i>Kliente per mallra, produkte e sherbime</i>	5	37,983,234	45,917,551
<i>Kerkesa te tjera te arketueshme</i>		76,049	
<i>Instrumente te tjera borxhi</i>			
<i>Investime te tjera financiare</i>			
		<u>38,059,283</u>	<u>45,917,551</u>
Inventaret			
<i>Materiale te para</i>			
<i>Prodhimi ne proces</i>			
<i>Produkte te gatshme</i>			
<i>Mallra per rishitje</i>			
<i>Parapagime per furnitoret</i>			
Aktive biologjike afatshkurtra			
Aktive afatshkurtra te mbajtura per shitje			
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra			
Totali aktiveve afatshkurtra		<u>51,568,037</u>	<u>93,173,535</u>
Aktive afatgjata			
Investime financiare afatgjate			
<i>Aksione dhe pjesemarrje ne shoqerite e kontrolluara</i>			
<i>Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje</i>			
<i>Aksione dhe letra te tjera me vlere</i>			
<i>Kerkesa te arketueshme afatgjata</i>			
Aktive afatgjata materiale			
<i>Toka</i>			
<i>Ndertesa</i>			
<i>Makineri dhe paisje</i>			
<i>Aktive te tjera afatgjata materiale</i>	6	715,190	755,885
Aktive biologjike afatgjata			
Aktive afatgjata jomateriale			
<i>Emri i mire</i>			
<i>Shpenzimet e zhvillimit</i>			
<i>Aktivet te tjera afatgjata jomateriale</i>		12,795,137	
Kapitali aksionar i papaguar			
Aktive te tjera afatgjata			
Totali aktiveve afatgjata		<u>13,510,327</u>	<u>755,885</u>
TOTALI AKTIVEVE		<u>65,078,364</u>	<u>93,929,421</u>

Hartoi



Ekonomiste

Konstantina

Administratori



Pasqyrat financiare vjetore për periudhën
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2014

Bilanci kontabel - Pasiv

PASIVET DHE KAPITALI

Derivativet

Huamarrje

Hua dhe obligacione afatshkurtra
Kthime/ripagesa te huave afatgjata
Aksione te konvertueshme

Detyrime tregtare dhe te tjera

Te pagueshme ndaj furnitoreve

8 15,185,612 35,424,006

Detyrime ndaj personelit

307,593 1,260

Detyrime tatimore afatshkurtra

9 4,034,464 3,586,184

Detyrime te tjera

715,115 609,300

Parapagime

9,877,387

20,251,783**49,498,137**

Grandet dhe te ardhura te shtyra

Provisionet afatshkurtra

Totali pasiveve afatshkurtra**20,251,783****49,498,137**

Hua dhe letra me vlere afatgjata

*Hua, letra me vlere dhe detyrime nga qiraja financiare**Aksione te konvertueshme*

Huamarrje te tjera afatgjata

Provizionet afatgjata

Grandet dhe te ardhurat e shtyra

Totali pasiveve afatgjata

0

0

Totali pasiveve**20,251,783****49,498,137**

Kapitali

Aksionet e pakices

Kapitali i aksionereve te shoqerise meme

Kapitali aksionar

35.579.000 35.579.000

Primi i aksioneve

Rezerva statutore

Rezerva ligjore

Rezerva te tjera

1,854,013 1,579,677

Fitimet e pashperndara

6.880.699 6.880.699

Fitim / Humbja e vitit financiar

512,869 391,908


Total kapitali**44,826,581****44,431,284****TOTALI PASIVEVE DHE KAPITALIT****65,078,364****93,929,421**

Hartoi



Ekonomiste

Administratori




Pasqyrat financiare vjetore për periudhën
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2014

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

Per vitin financiar deri me 31 Dhjetor 2014

	Shënime	Në Lekë 2014	2013
Te ardhurat	1	53,045,078	66,666,312
Kosto e mallrave te shitura	2	(42,278,474)	(52,689,273)
Fitimi bruto		10,766,604	13,977,039
Kosto te shpendarjes	3	(1,236,399)	(2,488,536)
Shpenzime administrative	4	(8,372,115)	(10,795,751)
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit			
Shpenzime te tjera te zakonshme			
Fitimi nga veprimtarite e shfrytezimit		1,158,090	692,752
Te ardhura dhe shpenzime financiare nga shoqerite e kontrolluara			
Te ardhura dhe shpenzime nga investime ne pjesemarrjet			
Te ardhura dhe shpenzime financiare			
<i>Te ardhura dhe shpenzime financiare nga investime te tjera afatgjata</i>			
<i>Te ardhura dhe shpenzime interesi</i>			
<i>Fitim/humbje nga kembimet valutore</i>	5	(461,972)	(36,260)
<i>Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare</i>			
Te ardhura dhe shpenzime financiare neto		(461,972)	(36,260)
Fitim (humbje) para tatimit		696,118	656,492
Shpenzime te tatimit mbi fitimin		183,249	264,584
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		512,869	391,908

Hartoi



Ekonomiste

Konstantina Gjallica
Administratore



Pasqyrat financiare vjetore për periudhën
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2014

Pasqyra e fluksit të parave

Për vitin financiar deri më 31 Dhjetor 2014

	Në Lekë	
	2014	2013
Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitimi para tatimit	696,118	656,492
Rregullime per:		
Amortizimin	1,004,186	217,258
Humbje nga kembimet valutore		
Te ardhura nga investimet		
Shpenzime per interesat		
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme	7,858,268	16,952,735
Rritje/renie ne tepricen e inventarit		
Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve per t'u paguar	(29,246,353)	27,839,394
Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve te tjera		
Parate e perfituara nga aktivitetet	(19,687,782)	45,665,878
Interes i paguar		
Tatim fitimi i paguar	(183,249)	(264,584)
<i>Paraja neto nga aktivitetet e shfrytezimit</i>	(19,871,031)	45,401,294
Fluksi i parave nga veprimtarite investuese		
Blerja e shoqerise se kontrolluar X minus parate e arketuara		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(110,483)	
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	(13,648,146)	
Te ardhura nga shitja e paisjeve		
Interes i arketuar		
Dividente te arketuar		
<i>Paraja neto e perdorur ne aktivitetet investuese</i>	(13,758,629)	0
Fluksi i parave nga veprimtarite financiare		
Te ardhura nga emetimi I kapitalit aksionar		
Te ardhura nga huamarrje afatgjata		
Pagesat e detyrimeve te qirase financiare		
Dividente te paguar	(117,570)	(677,000)
<i>Paraja neto e perdorur ne aktivitetet financiare</i>	(117,570)	(677,000)
Rritja/renia neto e mjeteve monetare	(33,747,230)	44,724,294
Mjete monetare ne fillim te periudhes kontabel	47,255,985	2,531,694
Mjete monetare ne fund te periudhes kontabel	13,508,755	47,255,988

Hartoi



Ekonomiste

Konstantina Shkollari
 Administratori
 C.R.I. Albania Shpk.
 Mip. K. 140401/14
 Tiranë, Albania

Pasqyrat financiare vjetore për periudhën
 nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2014

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

Për vitin financiar deri më 31 Dhjetor 2014

Në Lekë


	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Rezerva statutore dhe ligjore	Fitimi i pashpernda	Totali
Pozicioni me 31 Dhjetor 2012	35,579,000			9,137,376	44,716,376
Fitimi neto per periudhen kontabel				391,908	391,908
Dividendet e paguar				(677,000)	(677,000)
Rritje kapitali					
Emetimi i aksioneve					
Pozicioni me 31 Dhjetor 2013	35,579,000			8,852,284	44,431,284
Fitimi neto per periudhen kontabel				512,869	512,869
Dividendet e paguar				(117,570)	(117,570)
Emetim i kapitalit aksionar					
Rritje kapitali					
Pozicioni me 31 Dhjetor 2014	35,579,000			9,247,582	44,826,582

Hartoi



Ekonomiste

Konstantina Strati
Administratori



Pasqyrat financiare vjetore per periudhen
nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2014

Shënime**1. Informacion i përgjithshëm për Shoqërinë**

“C.R.I Albania” Sh.p.k (më poshtë “Shoqëria”), është shoqëri shqiptare me kapital të zotëruar nga Z.Georgios Sariagiannidis me 15% të kapitalit dhe “C.R.I Bulgaria EAD” 85% të kapitalit.

Shoqëria është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) datë 05.10.2007 dhe është pajisur me NIPT K72224014C, me seli Rr: Elbasanit, Kulla “American 2”, Zyra 216, Tiranë.

Gjatë vitit 2014 Shoqëria ka zhvilluar aktivitetin e shërbimeve në telekomunikacion.

Shoqëria ka pasur të punësuar 5 (pesë) persona në fund të vitit 2014.

2 Baza e përgatitjes**(a) Deklarata e përputhshmërisë së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare bashkangjitur janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë, e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

(e) Ndryshime në politikat kontabël

Duke filluar që nga 1 Janari 2009, Shoqëria aplikon SNK 1 të ndryshuar “Paraqitja e Pasqyrave Financiare (2007)”, i cili hyri në fuqi më 1 Janar 2009. Si rrjedhim, Shoqëria paraqet në pasqyrën e ndryshimeve në kapital të gjitha ndryshimet në lidhje me pronarët, ndërsa të gjitha ndryshimet e tjera që nuk lidhen me pronarët paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse. Informacioni krahasues është ri-paraqitur në mënyrë që të jetë në përputhje me standartin e ndryshuar. Ndryshimi në politikën kontabël prek vetëm aspektin prezantues të pasqyrave financiare.

3 Përmbledhje e politikave kontabël**(a) Aktive afatgjata materiale****(i) Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë jetës së dobishme të aktiveve. Metodot e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) janë rivlerësuar në datën e raportimit.

Jeta e dobishme për çdo kategori aktivesh për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si më poshtë:

▪ Makineri e paisje	20%
▪ Mjete transporti	20%
▪ Mobilje dhe orëndi	20%
▪ Pajisje zyre dhe informatike	25%

(b) Instrumentet financiarë

Shoqëria mban vetëm instrumente financiarë jo-derivativë, që përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, kredi dhe hua, dhe llogari të pagueshme. Instrumentet financiarë jo-derivativë janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus koston e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiarë jo-derivativë përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet në rast se Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose nëse Shoqëria i transferon aktivitetin financiar një palë tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktiviteti financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, p.sh. datën në të cilën Shoqëria zotohet të blejë ose të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, të tjera investime afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen me koston e amortizuar.

Kërkesa për arkëtim

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuar për humbjet për zhvlerësime.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

Huamarrjet

Huamarrjet nga aksionerët njihen fillimisht me kosto. Huamarrjet e tjera njihen fillimisht me vlerë të drejtë. Huamarrjet mbarten në vijim me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

(c) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse një evidencë objektive tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar.

Aktivet financiare të cilat janë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet bashkarisht në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku. Te gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në fitim ose humbje.

(d) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

(e) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë nga shitja e mallrave gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë. Të ardhurat paraqiten neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet dhe uljet. Të ardhurat njihen kur risqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë e mallrave janë transferuar tek blerësi, shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, kostot që kanë ndodhur ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme, dhe Shoqëria nuk është më e përfshirë në manaxhimin e mallrave dhe produkteve të shitura.

(f) Përfitimet e punonjësve

Sigurimet shoqërore të detyrueshm

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës janë të pagueshme kur marrëdhënia e punës ndërpritet nga Shoqëria përpara datës normale të daljes në pension, ose atëherë kur një punonjës pranon largimin vullnetar nga puna në shkëmbim të këtyre përfitimeve. Shoqëria njih përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës kur demonstroi se është e angazhuar: për të ndërprerë marrëdhëniet e punës të punonjësve aktualë sipas një plani zyrtar të hollësishëm dhe nuk ka mundësi realiste tërheqjeje, ose për të dhënë përfitime nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës si rezultat i një

oferte të bërë për të nxitur largimin vullnetar nga puna. Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës të pagueshme pas më shumë se 12 muajve pas datës së raportimit skontohen në vlerën aktuale.

(g) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

Shpenzimet e qirasë

Shpenzimet e qirasë së zakonshme janë ngarkuar në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë periudhës së qirasë. Pagesa motivimi marrë nga qiradhënësi janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë përgjatë periudhës së qirasë

(h) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga llogaritë në banka dhe fitimet neto nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, komisionet bankare dhe humbjet neto nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(i) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimit në bilanc, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur bazuar në metodën e realizimit ose kompensimit të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur shkallë tatimore që janë në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit aktivi të mund të përdoret. Aktivi tatimor i shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

(j) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje, përveç diferencave nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi i huave nga aksionerët të cilat njihen në të ardhurat përmbledhëse.

(k) Standarte dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

Një numër standartesh të reja, ndryshime në standarte dhe interpretime nuk janë ende efektive për fundin e vitit 31 Dhjetor 2014, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë prej tyre nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare detajohen si me poshte:

	2014	2013
Parate ne arke		
Monedhe kombetare	111,344	29,310
Monedhe te huaj	153,455	66,455
Llogarite ne banke		
Monedhe kombetare	1,092,459	42,838,162
Monedhe te huaj	12,151,497	4,322,058
Totali	13,508,755	47,255,985

5. Klientë

Klientet ne fund te vitit analizohen si me poshte.

	2014	2013
Kliente		
AMC	21,578,991	32,649,278
Vodafone Albania sha	16,404,243	13,286,273
Totali	37,983,234	45,917,551

6. Aktive afatgjata materiale

Analiza e këtij zeri paraqitet si më poshtë:

	2014	2013
Aktive afatgjate materiale (neto)		
Aktive afatgjate materiale (neto)	715,190	755,885
Totali	715,190	755,885

7. Aktive afatgjata jomateriale

Analiza e këtij zeri paraqitet si më poshtë:

	2014	2013
Aktive afatgjate materiale (neto)		
Aktive afatgjate jomateriale (neto)	12,795,137	-
Totali	12,795,137	-

8. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Analiza e këtij zëri paraqitet si më poshtë:

	2014	2013
Të pagueshme ndaj furnitorëve		
CRI I.C.T. SA	10,510,500	2,238,502

Horizon shpk	302,702	23,403,867
M - Sensis Greqi	4,204,256	7,105,393
Upstream Milano	-	2,646,530
Kazazi Consulting	117,718	-
Te tjera	50,436	29,714
Total	15,185,612	35,424,006

9. Detyrime tatimore afatshkurtra

Ky ze perfaqeson detyrimet ndaj shtetit per sigurimet shoqerore si dhe tatime te tjera.

Detyrime tatimore afatshkurtra	2014	2013
Sigurime Shoqërore	113,516	101,406
Tatimi mbi te Ardhurat Personale	49,554	70,640
Tatim fitimi	-	106,256
TVSH e pagueshme	3,880,394	3,307,882
Tatim në burim	-	-
Total	4,043,464	3,586,184

10. Fitimi (humbja) neto e vitit financiar

Fitimi (humbja) neto e vitit financiar e paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve detajohet si më poshtë:

1 Të ardhurat

	2014	2013
Te ardhura nga shitja		
Te ardhura nga sherbimet	53,045,078	66,666,312
Total	53,045,078	66,666,312

2 Shpenzimet

	2014	2013
Kosto e mirembajtjes	40,151,969	44,595,507
Blerje materialesh	161,520	6,315,193
Shpenzime transporti	-	-
Shpenzime paga	1,158,850	1,101,259
Shpenzime te sigurimeve shoqerore	192,668	183,903
Shpenzime karburanti	-	4,000
Shpenzime sherbimi, administrimi	47,591	406,421
Te tjera	565,877	82,990
Total	42,278,475	52,689,273

3 Shpenzimet e shpërndarjes

	2014	2013
Pagat per funksionin e shperndarjes	840,000	2,039,724
Shpenzimet e prezantimit	100,611	328,848
Sigurimet shoqerore te shperndarjes	295,788	119,964
Total	1,236,399	2,488,536

4 Shpenzimet administrative

	2014	2013
Shpenzimet e pages per administraten	3,457,491	4,702,317
Shpenzimet e qerase	755,609	750,883
Shpenzimet fiskale dhe te kontabilitetit	1,319,090	2,178,162
Shpenzimet e dietave	362,738	81,658
Shpenzimet juridike	141,428	336,402

Shpenzimet e sigurimeve per admin	440,838	492,505
Shpenzimet e telefonit	141,971	212,386
Penalitet e gjoba	36,447	947,776
Shpenzime te tjera	1,716,503	1,093,662
Total	8,372,115	10,795,751

5 Fitim/humbje nga kurset e këmbimit

	2014	2013
Te ardhurat nga diferencat e kurseve te kembimit	1,451	50,601
Shpenzimet nga diferencat e kurseve te kembimit	(463,424)	(86,861)
Total	(461,972)	(36,260)

Shpenzimet e Tatim Fitimit

	2014	2013
1. Fitimi/humbja e vitit para tatim fitimit	696,118	656,492
2. Shpenzime te pazbritshme	525,544	1,989,344
3. Humbja fiskale e mbartur		
4. Fitimi/humbja e tatueshme (1+2+3)	1,221,662	2,645,835
Tatim fitimi me 15%	183,249	264,584
Tatim fitimi i parapaguar	259,298	158,328
Tatim fitimi per t'u paguar	-	106,256

Përqindja e tatimit mbi fitimin për vitin 2014 sipas legjislacionit fiskal shqiptar është 15%. Deklarimi dhe pagesa e detyrimit të tatim fitimit bëhet çdo vit por fitimi dhe humbja fiskale mbeten të përlllogaritura derisa të kontrollohen nga autoritetet tatimore.